

URDHËR
Nr. 173, datë 28.7.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar, të germave “b” dhe “ç” të nenit 13 dhe të germës “a” të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe të germës “a” të pikës 1, të nenit 7, dhe germës “a” të pikës 1, të nenit 30, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit të znj. Laerta Rooze, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të kryer procedurat administrative dhe nënshkruar në emër të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, aktet që lidhen me mirëmbajtjen e godinës, ku ushtron veprimtarinë Kolegji i Posaçëm i Apelit, dhe të sistemeve të instaluar, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 518, datë 29.9.2017, në VKM-në nr. 230, datë 26.4.2018, dhe në legjislacionin në fuqi.

2. Znj. Laerta Rooze nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo